



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 453 Prot.

Tiranë, më datë 01.11.2019

**VENDIM**

**Nr.375, datë 01.11.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.11.2019,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Ndërtim i HEC "Dohoshisht 2 dhe 3", në përroin e Peshkopisë, Bashkia Peshkopi, Qarku Dibër me subjekt aplikues “Hidro One Energy” sh.p.k.  
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objekteve monument kulture: “Kisha e Shën Dhimitrit” dhe “Kisha e Shën Sotirit (Sveti Spas), në fshatin Kërçisht, Bashkia Dibër;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**



**Elva MARGARITI**